



Parimet e Administratës Publike

SIGMA është iniciativë e përbashkët e OECD-së dhe BE-së, e cila kryesisht financohet nga BE.

Ky dokument është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Ai nuk duhet të konsiderohet se paraqet qëndrimet zyrtare të BE-së, OECD-së apo të shteteve anëtare të saj, apo të përfituesve që marrin pjesë në Programin e SIGMA-s. Opinionet e shprehura dhe argumentet e përdorura janë të autorit(ve).

Ky dokument dhe çdo hartë e paraqitur në të nuk e paragjykojnë statusin apo sovranitetin mbi ndonjë territor, apo ndarjen e kufijve ndërkombëtarë apo emrin e ndonjë territori, qyteti apo rajoni.



Tabela e Përmbajtjes

Parathënie nga Johannes Hahn	4
Parathënie nga Mari Kiviniemi	5
Hyrje	6
1. Korniza strategjike e reformës së administratës publike	10
2. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	14
3. Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	18
4. Llogaridhënia	22
5. Ofrimi i shërbimeve	26
6. Menaxhimi i financave publike	30
Shënimet për fund	34
Lexoni më shumë për Parimet e Administratës Publike	35



Parathënie

Johannes Hahn

Komisioner për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimin

Komisioni është duke siguruar një fokus të fuqishëm në adresimin e reformave themelore herët në procesin e zgjerimit. Kjo qasje i kontribuon forcimit të besimit në politikën e zgjerimit dhe përmirësimit të fuqisë së tij transformuese.

Reforma e administratës publike është një shtyllë e procesit të zgjerimit, bashkë me sundimin e ligjit dhe qeverisjen ekonomike. Të tri këto shtylla janë të lidhura ngushtë, çështje të ndërthurura me rëndësi thelbësore për suksesin në reformat politike dhe ekonomike dhe në krijimin e bazës për zbatimin e rregullave dhe standardeve të BE-së. Një administratë publike që funksionon mirë është e domosdoshme për qeverisje demokratike. Ajo po ashtu drejtpërdrejtë ndikon në aftësinë e qeverive për të ofruar shërbime publike dhe për të kultivuar konkurrencën dhe zhvillimin.

Reforma e administratës publike duhet të çoi në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit dhe të sigurojë një fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Një shërbim civil i menaxhuar në mënyrë adekuate dhe profesionale, planifikimi dhe koordinimi më i mirë i politikave, procedurat e shëndosha administrative dhe menaxhimi më i mirë i financave publike janë me rëndësi

thelbësore për funksionimin e shtetit dhe për zbatimin e reformave që nevojiten për integrim në BE. Vendet duhet të shtojnë përpjekjet e tyre në përmirësimin e administratave të tyre publike në të gjitha nivelet në bazë të strategjive kombëtare. Kërkohej një përkushtim më i fuqishëm politik për të drejtuar procesin e reformës.

Duke njohur sfidat me të cilat përballen vendet që janë në procesin e zgjerimit, Komisioni është duke forcuar mbështetjen e tij për reformën e administratës publike. Komisioni synon të përdor maksimalisht mekanizmat dhe forumet ekzistuese për të çuar përpara reformat, qoftë përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit, negociatave për anëtarësim ose iniciativave të ndërmarra nga Komisioni me synime të qarta për vendet specifike. Komisioni po ashtu është duke aplikuar një dialog më të strukturuar të politikave për reformën e administratës publike me vendet që janë në procesin e zgjerimit në Grupet Speciale për Reformën e Administratës Publike.

Parimet e Administratës Publike të paraqitura në këtë publikim, që është rezultat i një partneriteti të suksesshëm afatgjatë në mes të Komisionit Evropian dhe OECD/SIGMA-s, do të lehtësojnë në masë të madhe progresin në këtë agjendë sfiduese.

Parathënie

Mari Kiviniemi

Zëvendëssekretare e Përgjithshme, OECD



Qeverisja e mirë dhe administrata publike funksionale janë thelbësore në krijimin dhe ruajtjen e besimit ndaj qeverisë, dhe në bërjen e reformave të nevojshme strukturore për rritjen e standardit jetësor në shoqëri. Rëndësia për të pasur një administratë të mirë është bërë veçanërisht e qartë gjatë krizës financiare globale. Resurset e kufizuara fokusuan diskutimet e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar në punën e qeverisë, duke e bërë të qartë se qeverisja e mirë ka ndikim të madh në atë se sa mirë kthehen paratë që janë në dispozicion në rezultate dhe të arritura sistematike.

Kjo është një sfidë e njohur për qeveritë e vendeve që synojnë integrimin në BE, pasi procesi i anëtarësimit kërkon që të bëhen reforma thelbësore në rrethana financiare që shpesh janë të kufizuara.

OECD dhe Komisioni Evropian i kanë bashkuar forcat e tyre për më shumë se 20 vjet përmes iniciativës SIGMA. Kjo iniciativë ofron mbështetje për forcimin e administratave publike dhe për zbatimin e reformave qeverisëse në vendet kandidatë potenciale për anëtarësim në BE ose që janë në fqinjësi të saj.

Parimet e Administratës Publike janë rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm. Ato kombinojnë dinamikën

e procesit të anëtarësimit në BE me ekspertizën e OECD-së për qeverisje duke bërë bashkë dekada të tëra të përvojës si nga vendet anëtare të BE-së ashtu edhe nga ato të OECD-së, përfshirë edhe vendet të cilat kanë kaluar nëpër procesin e anëtarësimit. Parimet ofrojnë një përshkrim të detajuar të administratës së mirë publike të cilën duhet ta synojnë vendet. Për herë të parë, Parimet ofrojnë një kornizë të monitorimit në mënyrë që qeveritë dhe politikbërësit të mund të përcjellin zbatimin e reformave të nevojshme përgjatë kohës.

Përmes një fokusimi të fuqishëm në zbatimin e reformave dhe mbledhjes së dëshmive mbi performancën e qeverisë, Parimet nuk paraqesin vetëm një grumbull kushtesh dhe kërkesash por ato po ashtu ndihmojnë në përgatitjen e vizionit për reformën e administratës publike dhe shërbejnë për të ndihmuar vendimmarrësit për të bërë këtë reformë.

Marrë në përgjithësi, korniza e re e përmirësuar për reformën e administratës publike do të fokusojë më mirë përpjekjet e përbashkëta të qeverive, Komisionit Evropian dhe OECD-së në përmirësimin e performancës së administratave publike.

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE ËSHTË THELBËSORE NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Një administratë publike funksionale është parakusht për qeverisje demokratike transparente dhe efektive. Si themel i funksionimit të shtetit, ajo përcakton aftësinë e qeverisë për të ofruar shërbime publike dhe për të kultivuar konkurrencën dhe zhvillimin e vendit. Ajo po ashtu luan rol thelbësor në procesin e integrimit evropian duke e bërë të mundur zbatimin e reformave thelbësore dhe duke organizuar dialogun efikas të anëtarësimit me Bashkimin Evropian (BE). Prandaj, kriteret e zgjerimit të BE-së e pranojnë dhe theksojnë nevojën që vendi të krijojë një administratë publike shtetërore që ka

kapacitetin të ndjek parimet e qeverisjes së mirë dhe që e bën transpozimin dhe zbatimin efektiv të *acquis*.

Komisioni Evropian (KE) ka forcuar fokusimin e tij në reformën e administratës publike (RAP) duke theksuar gjashtë çështjet kryesore të reformës dhe duke integruar më mirë reformën në procesin e zgjerimit përmes Grupeve të Veçanta për RAP dhe lidhjeve më të forta me negociatat për anëtarësim. Gjashtë fushat kryesore të reformës të përcaktuara nga Komisioni përbëjnë bazën e Parimeve të Administratës Publike, siç përshkruhet më poshtë.

QËLLIMI DHE FOKUSI I PARIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Parimet përkufizojnë se çfarë përfshin qeverisja e mirë në praktikë dhe përcaktojnë kushtet kryesore që duhet të respektohen nga vendet gjatë procesit të integrimit në BE. Parimet po ashtu përmbajnë një kornizë të monitorimit e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Koncepti i “qeverisjes së mirë” është përkufizuar vazhdimisht nga vendet e BE-së dhe është përfshirë në Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore . Nocioni “Hapësirë Administrative Evropiane” është krijuar nga SIGMA në vitin 1999 . Ai përfshin komponente si besueshmërinë, parashikueshmërinë, llogaridhënien dhe transparencën, si dhe kompetencat teknike dhe

menaxheriale, kapacitetin organizativ, qëndrueshmërinë financiare dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

Ndonëse kriteret e përgjithshme të qeverisjes së mirë janë universale, këto Parime janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e *acquis*, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë *acquis*. Në fushat e tjera, Parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre Parimeve themelore.

Në secilin vend, vëmendja e Qeverisë ndaj një Parimi të caktuar mund të ndryshojë varësisht nga struktura qeverisëse, kultura administrative, sfidave kyçe specifike për vendin, dhe historia me reformat e mëparshme. Kështu, korniza mundëson krijimin e një grumbulli koherent të kushteve në të gjitha vendet, duke i lejuar në të njëjtën kohë një vendi të caktuar fleksibilitet në përcaktimin e sfidave dhe objektivave të tij në RAP.

Parimet mbulojnë një fushë të sektorit publik të cilit i referohemi si “administratë shtetërore”. Ky emërtim përdoret gjerësisht në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai i paraqet dy elementet kryesore të kësaj sfere: “administratën publike” në “nivel (kombëtar ose qendror) shtetëror”. Parimet po ashtu mbulojnë edhe organet e pavarura kushtetuese, si dhe Parlamentin dhe gjyqësorin në kuadër të sferës së trajtimit të tyre dhe kompetencave për mbikëqyrjen e administratës shtetërore.

Parimet plotësohen me kornizën e monitorimit, e cila mundëson përcjelljen e progresit të arritur përgjatë

kohës në zhvillimin e administratës publike. Korniza e monitorimit përmban tregues sasiorë dhe cilësorë; ajo fokusohet në zbatimin e reformave dhe rezultatet për sistemin, d.m.th, se si administrata e bën punën e vet në praktikë. Treguesit cilësorë e masin pjekurinë e komponentëve përkatës të administratës publike në shkallën nga 1 (rezultati më i ulët) deri në 5 (rezultati më i lartë). Dëshmitë dhe të dhënat e nevojshme për monitorim mbliidhen gjatë procesit vjetor të vlerësimit të RAP-së nga OECD/SIGMA. Përveç treguesve të zhvilluar nga SIGMA, korniza e monitorimit përdor, aty ku duhet, edhe treguesit e njohur ndërkombëtarisht (p.sh., nga Forumi Ekonomik Botëror dhe Banka Botërore).

Niveli në të cilin një vend i caktuar kandidat ose kandidat potencial zbaton këto Parime në praktikë është tregues i kapacitetit të administratës publike të atij vendi për zbatimin efektiv të *acquis*, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagë (1993) dhe në Madrid (1995).



Parimet mbulojnë nivelet kryesore horizontale të sistemit të qeverisjes, të cilat përcaktojnë performancën e përgjithshme të administratës publike.

1

Korniza strategjike e reformës së administratës publike

2

Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

3

Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

4

Llogaridhënia

5

Ofrimi i shërbimeve

6

Menaxhimi i financave publike

1

Korniza Strategjike
e Reformës së
Administratës Publike

Korniza Strategjike e Reformës së Administratës Publike

PARIMI 1:

Qeveria e ka hartuar dhe miratuar një agjendë për reformë efektive të administratës publike e cila adreson sfidat kryesore.

PARIMI 2:

Reforma e administratës publike zbatohet me vendosmëri; janë përcaktuar rezultatet e reformës dhe ato monitorohen në mënyrë të rregullt.

PARIMI 3:

Sigurohet qëndrueshmëria financiare e reformës së administratës publike.

PARIMI 4:

Reforma e administratës publike ka struktura koordinuese të fuqishme dhe funksionale si në nivelin politik ashtu edhe në atë administrativ për të drejtuar dhe menaxhuar procesin e planifikimit dhe zbatimit të reformës.

PARIMI 5:

Një institucion udhëheqës ka përgjegjësinë dhe kapacitetin për të menaxhuar procesin e reformës; institucionet e përfshira kanë përgjegjësi të qartë dhe kapacitete për zbatimin e reformës.



TREGUESIT SASIORË

- Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor të aktiviteteve zhvillimore dhe reformave të administratës publike
- Pjesa e realizuar e objektivave të RAP-së.
- Pjesa e masave të RAP-së të cilave u janë alokuar resurse dhe u është caktuar kostoja.
- Raporti ndërmjet financimit të planifikuar nga IPA për RAP në programin sektorial të IPA-s dhe dokumenteve të planifikimit kombëtar.
- Lëvizja vjetore e stafit në njësinë që e udhëheq RAP-në.

TREGUESIT CILËSORË

- Shkalla në të cilën është kompletuar sfera e dokumentit(eve) qendrore të planifikimit të RAP-së.
- Shkalla në të cilën ekziston një sistem gjithëpërfshirës i raportimit dhe monitorimit të RAP-së.
- Shkalla në të cilën është përcaktuar llogaridhënia për funksionet e RAP-së.

2

Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

PARIMI 1:

Institucionet e Qendrës Qeverisë Qendrore përmbushin të gjitha funksionet kritike për një sistem të organizuar mirë, të qëndrueshëm dhe kompetent të politikë-bërjes.

PARIMI 2:

Janë përcaktuar dhe aplikohen procedura të qarta horizontale për qeverisjen e procesit kombëtar të integrimit evropian nën koordinimin e organit përgjegjës.

PARIMI 3:

Ekziston një planifikim afatmesëm i harmonizuar i politikave, me objektiva të qarta për tërë qeverinë, dhe ai është përshtatur me rrethanat financiare të Qeverisë; politikat sektoriale i realizojnë objektivat e Qeverisë dhe janë në përputhje me kornizën afatmesme buxhetore.

PARIMI 4:

Ekziston një sistem i harmonizuar i planifikimit afatmesëm për të gjitha proceset me rëndësi për integrimin evropian dhe ai është i integruar në planifikimin e politikave kombëtare.

PARIMI 5:

Monitorimi i rregullt i performancës së Qeverisë mundëson kontrollin publik dhe siguron që Qeveria të jetë në gjendje të arrijë objektivat e saj.

PARIMI 6:

Vendimet e Qeverisë përgatiten në mënyrë transparente dhe bazohen në gjykimin profesional të administratës; sigurohet edhe përputhshmëria e këtyre vendimeve me ligjin.

7. ËLKE:

Parlamenti shqyrton hollësisht bërjen e politikave të qeverisë.

PARIMI 8:

Struktura organizative, procedurat dhe caktimi i stafit të ministrive siguron që politikat dhe ligjet e hartuara të jenë të zbatueshme dhe të realizojnë objektivat e Qeverisë.

PARIMI 9:

Procedurat e integrimit evropian dhe struktura institucionale janë pjesë integrale e procesit të hartimit të politikave dhe sigurojnë transpozimin sistematik dhe me kohë të *acquis*.

PARIMI 10:

Bërja e politikave dhe procesi i hartimit të ligjeve bazohet në dëshmi dhe vlerësimi i ndikimit kryhet rregullisht në të gjitha ministrinë.

PARIMI 11:

Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë dhe mundëson koordinimin e perspektivave brenda Qeverisë.

PARIMI 12:

Struktura, stili dhe gjuha e legjislacionit janë të harmonizuara; kushtet për hartimin e ligjeve zbatohen në të gjitha ministrinë; legjislacioni vihet në dispozicion të publikut.



Shembuj të treguesve

TREGUESIT SASIORË

- Çështjet e pakryera në zbatimin vjetor nga zotimet e planifikuara në dokumentin(et) qendror të planifikimit.
- Raporti ndërmjet fondeve të përgjithshme të parashikuara në strategjitë sektoriale dhe financimit të përgjithshëm të identifikuar për sektorët përkatës në kuadër të kornizës afatmesme buxhetore.
- Numri i ligjeve me vendime gjyqësore kundër Qeverisë gjatë vitit.
- Mbetjet prapa në transpozim (raporti mes transpozimit dhe zotimeve të planifikuara).
- Raporti i ligjeve të iniciuara nga Qeveria dhe të aprovuara nga parlamenti jo më vonë se një vit pas paraqitjes.

TREGUESIT CILËSORË

- Përpjesëtimi i funksioneve kritike të qendrës së qeverisë që janë përmbushur nga institucionet.
- Plotësia e vlerësimeve/parashikimeve financiare në strategjitë e sektorëve.
- Shkalla në të cilën raportimi jep informata për rezultatet e arritura.
- Shkalla në të cilën procesi i zhvillimit të politikave i shfrytëzon më së miri mjetet analitike.
- Shkalla në të cilën konsultimet publike shfrytëzohen për hartimin e politikave dhe legjislacionit.

3

Shërbimi Publik dhe
Menaxhimi i Burimeve
Njerëzore

PARIMI 1:

Fushëveprimi i shërbimit publik është i përshtatshëm, i përkufizuar qartë dhe i zbatueshëm në praktikë.

PARIMI 2:

Është krijuar dhe është duke u zbatuar në praktikë korniza politike dhe ligjore për një shërbim publik profesional dhe koherent; struktura institucionale mundëson praktika të qëndrueshme dhe efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore në tërë shërbimin publik.

PARIMI 3:

Punësimi i nëpunësve publikë bazohet në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për uljen në pozitë dhe përfundimin e kontratës së nëpunësve publikë janë të qarta.

PARIMI 4:

Parandalohet ndikimi politik i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në pozitat e larta drejtuese.

PARIMI 5:

Sistemi i pagave të nëpunësve civilë bazohet në klasifikimin e vendeve të punës; ai është i drejtë dhe transparent.

PARIMI 6:

Është siguruar zhvillimi profesional i nëpunësve civilë; ai përfshin trajnimin e rregullt, vlerësimin e drejtë të performancës, dhe lëvizjen dhe ngritjen në pozitë bazuar në kritere objektive dhe transparente dhe në merita.

PARIMI 7:

Ekzistojnë masat për promovimin e integritetit dhe për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës në shërbimin publik.



TREGUESIT SASIORE

- Lëvizja vjetore e përgjithshme e nëpunësve civilë në nivel të administratës qendrore.
- Lëvizja e nëpunësve civilë në pozita të larta drejtuese në nivel të administratës qendrore brenda gjashtë muajsh të ndryshimit të Qeverisë.
- Përqindja e nëpunësve civilë në nivel të administratës qendrore nga përkatësitë e ndryshme etnike në raport me përbërjen e përgjithshme etnike në vend bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë.
- Raporti i kompensimit mesatar vjetor të nëpunësve të lartë civilë të qeverisë qendrore ndaj kompensimit të punëtorëve me shkollim të shkallës së tretë.
- Perceptimi i qytetarëve për integritetin dhe besueshmërinë e shërbimit publik.

TREGUESIT CILËSORË

- Shkalla në të cilën fushëveprimi i shërbimit publik është i përshtatshëm, i përkufizuar qartë dhe i zbatueshëm në praktikë.
- Shkalla në të cilën punësimi bazohet në parimin e meritës në të gjitha fazat e tij.
- Shkalla në të cilën është parandaluar ndikimi politik në punësimin dhe largimin nga pozitat e larta drejtuese në shërbimin publik.
- Shkalla në të cilën sistemi i pagesës së nëpunësve civilë është i drejtë dhe transparent dhe që zbatohet në praktikë.
- Shkalla në të cilën është krijuar sistemi i integritetit dhe anti-korrupsionit në shërbimin publik dhe i cili zbatohet në praktikë.

4

Llogaridhënia

PARIMI 1:

Organizimi i përgjithshëm i qeverisë qendrore është racional dhe ndjek politikat dhe rregulloret adekuate dhe mundëson llogaridhënien e duhur të brendshme, politike, gjyqësore, sociale dhe të pavarur.

PARIMI 2:

E drejta për informim publik është dekretuar në legjislacion dhe aplikohet vazhdimisht në praktikë.

PARIMI 3:

Ekzistojnë mekanizma funksionale për mbrojtjen si të të drejtave të individit për qeverisje të mirë ashtu edhe të interesit publik.

PARIMI 4:

Garantohet trajtimi i drejtë i çështjeve administrative përmes ankesave të brendshme administrative dhe shqyrtimeve gjyqësore.

PARIMI 5:

Autoritetet publike marrin përgjegjësi në rastet e keqbërjes dhe garantojnë korrigjimin dhe/ose kompensimin adekuat.



TREGUESIT SASIORË

- Numri i kërkesave për informacion publik të refuzuara nga autoritetet publike brenda një viti të caktuar.
- Pjesa e autoriteteve publike që mbajnë një regjistër të dokumenteve dhe një bazë të të dhënave.
- Përqindja e qytetarëve që kanë besim në Institucionin(et) e Avokatit të Popullit.
- Pjesa e rekomandimeve të institucioneve mbikëqyrëse për organet e administratës shtetërore të cilat janë zbatuar brenda dy viteve.
- Rastet e pazgjidhura administrative.

TREGUESIT CILËSORË

- Shkalla në të cilën struktura e përgjithshme e ministrive dhe organeve të tjera vartëse të qeverisë qendrore është racionale dhe koherente.
- Shkalla në të cilën drejta për qasje në informata publike është përfshirë në legjislacion dhe zbatohet në praktikë.
- Shkalla në të cilën ekzistojnë mekanizmat për sigurimin e kontrollit dhe balancës efektive mes pushteteve dhe kontrollit mbi organizatat publike.
- Shkalla në të cilën autoritetet publike marrin përgjegjësitë dhe garantojnë korrigjimin.

5

Ofrimi i Shërbimeve



PARIMI 1:

Ekzistojnë dhe zbatohen politikat për një administratë shtetërore të orientuar drejt qytetarit.

PARIMI 2:

Administrata e mirë është objektivi kryesor i politikave që përforcon ofrimin e shërbimeve publike, është e përfshirë në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë.

PARIMI 3:

Ekzistojnë mekanizmat për sigurimin e cilësisë së shërbimeve publike.

PARIMI 4:

Sigurohet qasja në shërbimet publike.



TREGUESIT SASIORË

- Shpenzimet për shërbimet e përgjithshme publike si pjesë e bruto prodhimit vendor.
- Përqindja e shfrytëzuesve të kënaqur me shërbimet publike.
- Pjesa e institucioneve ku janë zhvilluar rregullisht anketa për kënaqshmërinë e klientëve (të paktën çdo dy vite).
- Numri i qendrave për ofrimin e shërbimeve në një sportel (one-stop-shop) që ofrojnë shërbime për më shumë se tri institucione të ndryshme publike.
- Pjesa e institucioneve ku kanë mundësi qasjeje personat me karroca invalidësh.

TREGUESIT CILËSORË

- Shkalla në të cilën janë krijuar dhe zbatohen politika për ofrimin e shërbimeve të orientuara drejt qytetarit.
- Shkalla në të cilën aplikohen parakushtet politike dhe administrative për ofrimin e shërbimit elektronik (e-shërbimit).
- Shkalla në të cilën është krijuar dhe zbatohet në vazhdimësi korniza ligjore për administratë të mirë.

6

Menaxhimi i Financave Publike

PARIMI 1:

Qeveria publikon një kornizë afatmesme buxhetore për tërë qeverinë e cila bazohet në parashikime të besueshme dhe mbulon një periudhë kohore prej së paku tri vitesh; të gjitha organizatat buxhetore veprojnë në bazë të saj.

PARIMI 2:

Buxheti formulohet në përputhje me kornizën ligjore kombëtare, me shuma të caktuara gjithëpërfshirëse për shpenzime që janë në përputhje me kornizën afatmesme buxhetore dhe të cilat respektohen.

PARIMI 3:

Ministria e Financave ose autoriteti qendror i autorizuar i thesarit kontrollon në mënyrë të centralizuar shpërndarjen e fondeve nga llogaria unike e thesarit dhe siguron likuiditetin e parasë.

PARIMI 4:

Ekziston një strategji e qartë për menaxhimin e borxhit e cila zbatohet në mënyrë që respektohet synimi i përgjithshëm i vendit për borxhin dhe kostot e shlyerjes së borxhit mbahen nën kontroll.

PARIMI 5:

Sigurohet transparenca dhe kontrolli i hollësishëm i buxhetit.

PARIMI 6:

Korniza operationale për menaxhimin dhe kontrollin financiar përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat; zbatimi i saj nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që qeveris menaxhimin e financave publike dhe administratën publike në përgjegjësi.

PARIMI 7:

Secila organizatë publike zbaton menaxhimin dhe kontrollin financiar në pajtim me dokumentet e përgjithshme të politikave për menaxhimin dhe kontrollin financiar.

PARIMI 8:

Korniza operationale për auditim të brendshëm pasqyron standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon administratën publike dhe menaxhimin e financave publike në përgjithësi.

PARIMI 9:

Secila organizatë publike zbaton auditimin e brendshëm në përputhje me dokumentet e përgjithshme të politikave të auditimit të brendshëm, që janë të përshtatshme për organizatën.

PARIMI 10:

Rregulloret e prokurimit publik (përfshirë edhe partneritetet publiko-private dhe koncesionet) janë harmonizuar me *acquis*, përfshijnë fusha plotësuese që nuk mbulohen nga *acquis*, janë të harmonizuara me rregulloret përkatëse në fushat e tjera dhe zbatohen si duhet.

PARIMI 11:

Ekziston kapaciteti qendror institucional dhe administrativ për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar politikën e prokurimit në mënyrë efektive dhe efikase.

PARIMI 12:

Sistemi ankimor është harmonizuar me standardet e *acquis* për pavarësinë, ndershmërinë dhe transparencën dhe mundëson trajtimin e shpejtë dhe adekuat të ankesave dhe dënimeve.

PARIMI 13:

Operacionet e prokurimit publik respektojnë parimet themelore të trajtimit të barabartë, mos-diskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës, derisa sigurojnë shfrytëzimin e fondeve publike në mënyrën më efektive dhe përdorimin më të mirë të mundshëm të teknikave dhe metodave moderne të prokurimit.

PARIMI 14:

Autoritetet dhe subjektet kontraktuese kanë kapacitetet e duhura, udhëzimet dhe instrumentet praktike për të siguruar menaxhimin profesional të tërë ciklit të prokurimit.

PARIMI 15:

Pavarësia, mandati dhe organizimi i Institucionit Suprem të Auditimit përcaktohen dhe mbrohen me kornizën kushtetuese dhe ligjore dhe respektohen në praktikë.

PARIMI 16:

Institucioni Suprem i Auditimit i zbaton standardet në mënyrë neutrale dhe objektive për të siguruar auditime cilësore që ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.



TREGUESIT SASIORË

- Bilanci i përgjithshëm i buxhetit të qeverisë.
- Kostoja e shlyerjes së borxhit të sektorit publik.
- Numri i ankesave në lidhje me numrin njoftimeve të publikuara për tendera.
- Përqindja e kontratave të dhëna përmes procedurave konkurruese.
- Pjesa e rekomandimeve të auditimit të bëra nga Institucionet Supreme të Auditimit të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga të audituarit.

TREGUESIT CILËSORË

- Indeksi i fuqisë së rregullave fiskale.
- Shkalla në të cilën raporti vjetor financiar përfshin informacion të plotë dhe vihet me kohë në dispozicion të Parlamentit.
- Cilësia e raporteve të auditimit të brendshëm.
- Shkalla në të cilën është i kompletuar dhe zbatohet legjislacioni i prokurimit publik.
- Shkalla në të cilën Institucionet Supreme të Auditimit përdorin standardet për të siguruar punë audituese cilësore.



1. “Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-2015”, Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve; COM(2014) 700 final, 8.10.2014 Bruksel.
2. Neni. 41. E drejta për administratë të mirë. 1. Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij apo të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet, organet dhe agjencitë e Bashkimit [Evropian]. 2. Kjo e drejtë përfshinë: të drejtën e secilit person për tu dëgjuar, para se të merret çfarëdo mase individuale e cila do të prekte atë negativisht; të drejtën e çdo personi të ketë qasje në dosjen e tij apo të saj, duke respektuar interesat legjitime të konfidencialitetit dhe të fshehtësisë profesionale dhe afariste; obligimin që administrata të jap arsye për vendimet e saj.
3. “Parimet Evropiane të Administratës Publike”, Dokumentet e SIGMA-s, Nr. 27, Publikimet e OECD, <http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5kml60zwd7h.pdf?expires=1398415030&id=id&accname=guest&checksum=FD455B0079C9FE4E957DE2E41D6A25CA>
4. Në broshurën e pasqyrës së përgjithshme janë dhënë shembuj të treguesve. Korniza complete e monitorimit është e paraqitur në versionin e plotë të Parimeve të Administratës Publike.



Nën-parimet që specifikojnë kushtet për secilin parim dhe metodologjia për analizimin e performancës së vendit krahasuar me Parimet janë paraqitur në versionin e plotë të Parimeve të Administratës Publike, i cili është në dispozicion në formë digjitale në faqen e internetit të OECD/SIGMA-s:

www.sigmaweb.org

Për më shumë informacion:

OECD/SIGMA

2 Rue André Pascal
75775 Paris Cedex 16
France

mailto: sigmaweb@oecd.org

Tel: +33 (0) 1 45 24 82 00

Fax: +33 (0) 1 45 24 13 05

www.sigmaweb.org